

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Drejtuar më Dostavljeno	04.08.2025	
Nr. orig. Org. lodi	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
02-016/01-00458		50/125
PODUJEVË - PODUJEVO		



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës
Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



K O N T R A T Ë

PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM AFAT SHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Palët kontraktuese

1. **Komuna e Podujevës**, të cilën e përfaqëson kryetari i kësaj komune, Z. Shpejtim Bulliqi, i cili në tekstin vijues do të quhet "Komuna e Podujevës".
2. **Ndërmarrja Publike Lokale "Eko Llapi" SH.A. Podujevë**, të cilën e përfaqëson Z. Bujar Çitaku.

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është dhënia në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko Llapi" SH.A. Podujevë.

Prona e paluajtshme që jepet në shfrytëzim është prona që shtrihet në njësinë kadastrale:

- P-71712062-2871-0 me sipërfaqe 3802 m²
Zona Kadastrale Podujevë.

Neni 2

Kohëzgjatja e Shfrytëzimit

Komuna dhe shfrytëzuesi janë pajtuar që prona komunale, sipas nenit 1 të kësaj kontrate, të merret në shfrytëzim për një periudhë prej 10 (dhjetë) vjetësh, duke ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike.

Prona e paluajtshme e cekur në nenin 1 të kësaj kontrate jepet në shfrytëzim pa kompensim.

Neni 3

Baza Ligjore

Kontrata për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës është e bazuar në:

- a. Ligjin për Vetqeverisjen Lokale nr. 03/L-040
- b. Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Ligji nr. 06/L-092

c. Vendimi Nr. prot. 01-461/01-0029110/25 , datë 28.05.2025, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko Llapi" SH.A. Podujevë.

Neni 4 **Obligimet e Komunës**

1. Komuna është e obliguar që t'ia dorëzojë Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko Llapi" SH.A. Podujevë pronat, me të dhënat e theksuara në vendimin e Kuvendit të Komunës së Podujevës Nr. prot. 01-461/01-0029110/25 , datë 28.05.2025, datë 28.05.2025, për njësinë kadastrale të theksuar si në nenin 1 të kësaj kontrate.
2. Komuna obligohet që të evidentojë shënimet përkatëse në librat e pronësisë për shfrytëzimin e pronës komunale.

Neni 5 **Obligimet e Shfrytëzuesit**

- Shfrytëzuesi nuk ka të drejtë që në asnjë mënyrë pronën e paluajtshme të marrë në shfrytëzim ta bartë tek persona të tretë.
- Shfrytëzuesi nuk ka të drejtë ta ndërrojë veprimtarinë me të cilën ka aplikuar.
- Shfrytëzuesi nuk mund të bëjë ndryshime dhe modifikime hapësinore pa lejen me shkrim të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.
- Shfrytëzuesi është i obliguar të kryejë të gjitha shërbimet komunale si uji, rryma, mbeturinat, etj., nga dita e marrjes në shfrytëzim.

Neni 6 **Inspektimi**

Komuna ka të drejtë të kontrollojë dhe inspektojë pronën e paluajtshme të komunës në çdo kohë, pa pasur kundërshtim nga shfrytëzuesi. Inspektimi ka për qëllim të konstatojë gjendjen momentale të pronës komunale gjatë kohës së shfrytëzimit nga shfrytëzuesi.

Neni 7 **Ndërprerja e Kontratës**

Palët kontraktuese e deklarojnë vullnetin e përbashkët për shkëputjen – ndërprerjen e kësaj kontrate në rastet vijuese:

- Në rast të ndonjë interesi më të lartë publik, kontraktuesi i parë, Komuna e Podujevës, mund të bëjë shkëputjen e kontratës në mënyrë të njëanshme. Afati për lirim është 30 ditë nga dita e njoftimit me shkrim dhe të gjitha shpenzimet do t'i bartë shfrytëzuesi.
- Nëse me dëshmi përkatëse të mbikëqyrjes inspektive konstatohet se shfrytëzuesi nuk e shfrytëzon pronën komunale në përputhje me kushtet e kontratës.
- Nëse me dëshmi përkatëse të mbikëqyrjes inspektive konstatohet se shfrytëzuesi ka bërë ndërrimin e destinimit të pronës së paluajtshme të dhënë në shfrytëzim.

- Me heqjen dorë të shfrytëzuesit nga shfrytëzimi i pronës komunale, duke njoftuar me shkrim për këtë komunën në afatin prej 30 ditësh para kohës kur shfrytëzuesi nuk dëshiron ta shfrytëzojë pronën e paluajtshme.

Neni 8 Zbatimi i Kontratës

Për zbatimin në tërësi të kësaj kontrate do të kujdeset kryetari i komunës, duke autorizuar komisionin me autorizim të veçantë.

Në rast të mos realizimit të kushteve të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, kryetari i komunës merr vendim për shkëputjen e kontratës dhe me këtë vendim njoftohet Kuvendi i Komunës.

Hyrja në Fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

Kontrata është përpiluar në 5 ekzemplarë autentikë dhe përbën 3 faqe. Pas leximit nga palët kontraktuese, ajo është nënshkruar pa vërejtje.

Me kopje të kësaj kontrate do të njoftohen Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrotjtje të Mjedisit, dhe Drejtoria për Inspektim.

Palët kontraktuese

Komuna e Podujevës

Z. Shpejtim Bulliqi



Nr prot _____

datë _____

NPL "Eko Llapi" SH.A.

Z. Bujar Çitaku

